



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALF

MINISTRI

Nr. 1445 prot.

Tiranë, më 15 / 03 / 2020

URDHËR

Nr. 175, datë 15 . 03 . 2020

PËR

CAKTIMIN E KOORDINATORIT PËRGJEGJËS PËR ADMINISTRIMIN E PERSONELIT MJEKËSOR, INFERMIEROR DHE ATYRE VULLNETAR NË SISTEMIN SHËNDETËSOR PËR TRAJTIMIN E INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat “ç” të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve në kuadër të shpalljes së gjendjes së epidemisë me Urdhërin nr. 156/2 datë 11.03.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e Profesor Arben Gjatës, Shef i Shërbimit të Kirurgjisë, QSUT, Koordinator përgjegjës për organizimin, trajnimin dhe administrimin e burimeve njerëzore ekzistuese dhe vullnetare.
2. Koordinatorin përgjegjës të marrë masa të menjëhershme për organizimin e trajnimit të personelit mjekësor dhe infermieror ekzistues dhe atij vullnetar për të siguruar vazdimësinë e shërbimeve mjekësore pranë strukturave spitalore ku trajtohen pacientë me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.
3. Koordinatorin përgjegjës të organizojë punën për ngritjen e një ekipi teknik dhe së bashku me strukturat e MSHMS të hartojë planin e shpërndarjes së burimeve njerëzore sipas nevojave, pasi analizimit të eksperiencës së secilit dhe trajnimeve të realizuara sipas pikës 2 të këtij urdhëri bazuar në aplikimet paraqitura në portalet Mjekë për Shqipërinë dhe Infermierë për Shqipërinë.
4. Koordinatorin përgjegjës të koordinojë punën për të shpërndarë personelin mjekësor dhe infermieror vullnetar të trajnuar sipas nevojave në të gjithë strukturën

shëndetësore që trajtohen pacientë me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 sipas skenarëve të miratuar nga Komiteti Teknik i Ekspertëve.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, dhe të gjithë strukturat që trajtojnë pacientë me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

